

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Objekti i Kontratës: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi, për Spitalin psikiatrik “DR. Sadik Dinci”, Elbasan dhe Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi, për Spitalin “Memorial” Fier”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP) 15894220-9.

VLERA E FONDIT LIMIT: 513,361,395 (Pesëqind e trembëdhjetë milion e treqind e gjashtëdhjetë e një mijë e treqind e nëntëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH, ose 5 115 708.97 (Pesëmilion e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetë pikë nëntëdhjetë e shtatë) Euro, ndarë në LOT-e.

Lot 1- 473,193,270(Katërqind e shtatëdhjetë e tre milion e njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e dyqind e shtatëdhjetë) pa TVSH ose **4,715,428.7** (katër milion e shtatëqind pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e njëzet e tetë pike 7) Euro.

Lot II- 40,168,125 (Dyzet milion e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëqind e njëzet e pesë) Lekë pa TVSH ose **400,280.269** (Katërqind mijë e dyqind e tetëdhjetë pikë dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë) euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blervje të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

Sipas parashikimeve ligjore për procedurat të cilat realizohen nga Organi Qëndror Blerës, Specifikimet Teknike, Termat E Referencës dhe llogaritja e Fondit Limit përcillen nga Autoritete Kontraktore të cilat kërkojnë shërbimin, në rastin konkret për LOT I janë përcjellë nga AK-Spitali Psikiatrik Sadik Dinci, Elbasan dhe për LOT II nga Spitali Memorial i Fierit.

Shtojca 8-Kriteret e Vecanta për Kualifikim është hartuar për secilin LOT si vijon:

Shtojca 8-LOT I “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi, për Spitalin psikiatrik “DR. Sadik Dinci”, Elbasan

. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatorët ekonomikë, duhet të disponojnë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”. Këtë licensë, nuk mund t’ja japë një operatori tjetër për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në objektin e prokurimit, në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018.

2. Operatorët ekonomikë, duhet të posedojnë të paktën një stabiliment të licensuar për prodhimin e ushqimit. Ky stabiliment duhet të jetë brenda bashkisë ku do të zbatohet marrëveshja kuadër. Objekti mund të jetë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore.

Argumentim: Kriteri vendoset sipas ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, neni 19. Kërkohej që stabilimenti të ndodhet brenda bashkisë ku do të zbatohet marrëveshja kuadër pasi ushqimi do të përgatitet në atë ambient dhe më pas do të transportohet në qendrat ku ndodhen pacientët dhe stafë mjekësor. Ushqimi duhet të jetë i gatuar rishtaz.

3. Operatorët ekonomikë, duhet të paraqesin një deklaratë se stabilimenti plotëson kushtet higjieno sanitare dhe tekniko-teknologjike për veprimtarinë e prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes me shumicë të ushqimeve për njerëz.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në objektin e prokurimit, në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018.

4. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin deklaratë se nga kontrolli i fundit i realizuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në objektin e prokurimit, në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të

kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Shenim: Kur konkuron për të 2 (dy) Lotet së bashku ofertuesi duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të LOTEVE për të cilat ofertuesi konkurren.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.
 - b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.

Shenim: Kur konkurren për të (2) dy lotet së bashku Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës , shërbime të mëparshme të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 39 % e fondit limit të LOTEVE për të cilat ofertuesi konkurren.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Prvoja e ngjashme është një siguri që operatorët ekonomik kanë eksperiencë për zbatimin e kontratës.

2. Operatorët ekonomikë për kryerjen e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, objekt prokurimi duhet të kenë jo më pak se 28 (njëzet e tetë) persona të punësuar, sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjesve
1.	Drejtues teknik: Mercollog/Kimist	1 një
2.	Kuzhinier	3 gjashtë
3.	Ndihmes Kuzhinier	6 gjashtë
4.	Punonjes shperndares ushqimesh ne ambientet e AK	15 pesëmbëdhjetë
5.	Shofer	3 tre
	Total	28 njezet e tetë

Në fazën e ofertimit, për punonjësit, të plotësohet në vetëdeklarimi sipas Shtojcës 9, ndërsa në rast të kualifikimit, përpara shpalljes së fituesit paraprak, duhet të paraqiten dokumentat:

a) Për drejtuesin teknik/(Mercollog/Kimist):

- Diplomë me profesion Mercollog/Kimist,
- Kontratë pune,
- Librezë pune ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën jo më pak se dy vite.

b) Për Kuzhinierin:

- Diplomë ose çertifikatë kualifikimi në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional,
- Kontratë pune,
- Librezë pune ose do dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën jo me pak se 2 dy vite.

c) Për ndihmës kuzhinierin:

- Kontratë pune si ndihmës kuzhinier,
- Librezë pune dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën jo me pak se 1 një vit.

d) Për punonjësit për shpërndarje ushqimi, të paraqitet:

- Kontratë pune.

dh) Për punonjesit Shofer, të paraqitet:

- Kontratë pune si shofer,
- Leje Drejtimi për mjetet e kërkuara, në përputhje me Legjislacionin në fuqi.

Argumentim: Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës dhe termave të referencës, hartuar nga AK. Në këto dokumenta specifikohet se duhet të sigurohet ushqimi i freskët, i shëndetshëm, i kontrolluar dhe sipas dietave të përcaktuara nga MSH për një mesatare prej 324 pacientësh në vit.

Do të planifikohet, sigurohen ushqimet, do të përpunohen, gatuhet, transportohet dhe shpërndahet ushqimi tek pacientet në tre qendra, tre herë në ditë, për tre vakte. Operatorët ekonomik, me anë të stafit të kërkuar, do të kryejnë në mënyrë shteruese shërbimin e gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit. Shërbimi do të garantohet për 24 njëzete katër orë.

2,1 Operatoret ekonomikë duhet të deklarojnë se punonjësit e deklaruar për këtë kontratë nuk do të jenë të angazhuar në kontrata të tjera dhe do të trajtohen sipas Legjislacionit të Punës së RSH.

Argumentim: Meqenëse është kërkuar një shërbim i përditshëm dhe me kohëzgjatje 24 h, punonjësit e kërkuar do të jenë të punësuar me kohë të plotë në këtë marrëveshje kuadër.

2. Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimumi 3 (tre) mjete transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore. Mjetet mund të jenë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore. Në fazën e ofertimit të plotësohet në vetëdeklarimi sipas Shtojcës 9, ndërsa në rast të kualifikimit, përpara shpalljes së fituesit paraprak, të paraqitet dokumentacioni i plotë si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje apo përdorimi dhe leje qarkullimi.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në objektin e prokurimit, në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Automjetet do të shërbejnë për të transportuar ushqimin, në tre vakte në tre qendrat e përcaktuara.

3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë me anë të së cilës të deklarojnë se mundësojnë transportimin e ushqimit me mjetet e veta, deri në ambientet e Autoritetit Kontraktor.
4. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë se ushqimi do të etiketohet dhe do të identifikohet nëpërmjet dokumenteve dhe çdo lloj informacioni tjetër, për të siguruar gjurmueshmërinë e tij sipas percaktimeve ligjore në fuqi.
5. Operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë disponimin ose mundësinë e disponimit të materialeve dhe mjeteve profesionale të domosdoshme/inventari i imët, të kërkuara në shtojcën 5 të DST.

Argumentim: Kriteret vendosen në përputhje me objektin e prokurimit, bazuar në kërkesat e AK në Specifikime Teknike dhe Terma Reference si dhe në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018.

Shënim: Rastet kur konstatohen deklaratat e rreme, të paraqitura nga operatorët ekonomik në përmbushje të kriterëve kualifikuese, do të konsiderohen si kusht për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentat e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentat e kërkuar sipas legjislacionit të fushës.

Shtojca 8- LOT II “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi, për Spitalin “Memorial” Fier”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1. Operatorët ekonomikë, duhet të disponojnë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”. Këtë licensë, nuk mund t’ja japë një operatori tjetër për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në objektin e prokurimit, në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018.

1. Operatorët ekonomikë, duhet të posedojnë të paktën një stabiliment të licensuar për prodhimin e ushqimit. Ky stabiliment duhet të jetë brenda bashkisë ku do të zbatohet marrëveshja kuadër. Objekti mund të jetë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore.

Argumentim: Kriteri vendoset sipas ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, neni 19. Kërkohej që stabilimenti të ndodhet brenda bashkisë ku do të zbatohet marrëveshja kuadër pasi ushqimi duhet të jetë i gatuar rishtaz.

2. Operatorët ekonomikë, duhet të paraqesin një deklaratë se stabilimenti plotëson kushtet higjieno sanitare dhe tekniko-teknologjike për veprimtarinë e prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes me shumicë të ushqimeve për njerëz.

3.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në objektin e prokurimit, në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018.

4. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin deklaratë se nga kontrolli i fundit i realizuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në objektin e prokurimit, në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018.

2.3 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Shenim: Kur konkuron për të 2 (dy) Lotet së bashku ofertuesi duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të LOTEVE për të cilat ofertuesi konkurren.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

6. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - c) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
 - d) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Kur konkurrenca për të (2) dy lotet së bashku Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, shërbime të mëparshme të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 39 % e fondit limit të LOTEVE për të cilat ofertuesi konkurrenca.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Prvoja e ngjashme është një siguri që operatorët ekonomik kanë eksperiencë për zbatimin e kontratës.

2. Operatorët ekonomikë për kryerjen e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, objekt prokurimi duhet të kene jo më pak se 7 (Shtatë) persona të punësuar, sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjesve
1.	Drejtues Teknik Mercollog/Kimist	1
2.	Kuzhinier	1
3.	Ndihmes Kuzhinier	2
4.	Punonjes shperndares ushqimesh ne ambjentet e AK	2
5.	Shofer	1
	Total	7 (shtatë)

Në fazën e ofertimit, për punonjësit, të plotësohet në vetëdeklarimi sipas Shtojcës 9, ndërsa në rast të kualifikimit, përpara shpalljes së fituesit paraprak, duhet të paraqiten dokumentat:

e) **Për drejtuesin teknik/(Mercollog/Kimist):**

- Diplomë me profesion Mercollog/Kimist,
- Kontratë pune,
- Librezë pune ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën jo më pak se dy vite.

f) **Për Kuzhinierin:**

- Diplomë ose çertifikatë kualifikimi në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional,
- Kontratë pune,
- Librezë pune ose do dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën jo me pak se 2 dy vite.

g) **Për ndihmës kuzhinierin:**

- Kontratë pune si ndihmës kuzhinier,
- Librezë pune dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën jo me pak se 1 një vit.

h) **Për punonjësit për shpërndarje ushqimi, të paraqitet:**

- Kontratë pune.

dh) **Për punonjesit Shofer, të paraqitet:**

- Kontratë pune si shofer,
- Leje Drejtimi për mjetet e kërkuara, në përputhje me Legjislacionin në fuqi.

Argumentim: Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës dhe termave të referencës, hartuar nga AK.

Do të planifikohet, sigurohen ushqimet, do të përpunohen, gatuhet, transportohet dhe shpërndahet ushqimi tek pacientet tre herë në ditë, për tre vakte. Operatorët ekonomik, me anë të stafit të kërkuar, do të kryejnë në mënyrë shteruese shërbimin e gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit. Shërbimi do të garantohet për 24 njëzete katër orë.

3. Operatoret ekonomikë duhet të deklarojnë se punonjësit e deklaruar për këtë kontratë nuk do të jenë të angazhuar në kontrata të tjera dhe do të trajtohen sipas Legjislacionit të Punës së RSH.

Argumentim: Meqenëse është kërkuar një shërbim i përditshëm dhe me kohëzgjatje 24 h, punonjësit e kërkuar do të jenë të punësuar me kohë të plotë në këtë marrëveshje kuadër.

4. Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimumi **1** (një) mjet transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore. Mjeti mund të jenë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore. Në fazën e ofertimit të plotësohet në vetëdeklarimi sipas Shtojcës 9, ndërsa në rast të kualifikimit, përpara shpalljes së fituesit paraprak, të paraqitet dokumentacioni i plotë si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje apo përdorimi dhe leje qarkullimi.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në objektin e prokurimit, në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Automjeti do të shërbejë për të transportuar ushqimin.

5. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë me anë të së cilës të deklarojnë se mundësojnë transportimin e ushqimit me mjetet e veta, deri në ambientet e Autoritetit Kontraktor.
6. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë se ushqimi do të etiketohet dhe do të identifikohet nëpërmjet dokumenteve dhe çdo lloj informacioni tjetër, për të siguruar gjurmueshmërinë e tij sipas percaktimeve ligjore në fuqi.
7. Operatori ekonomik duhet të deklarojë disponimin ose mundësinë e disponimit të materialeve dhe mjeteve profesionale të domosdoshme/inventari i imët, të kërkuara në shtojcën 5 te DT.

Argumentim: Kriteret vendosen në përputhje me objektin e prokurimit, bazuar në kërkesat e AK në Specifikime Teknike dhe Terma Reference si dhe në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018.

Shënim: Rastet kur konstatohen deklaratat të rreme, të paraqitura nga operatorët ekonomik në përmbushje të kriterëve kualifikuese, do të konsiderohen si kusht për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentat e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentat e kërkuar sipas legjislacionit të fushës.

Data e publikimit të njoftimit është **24.05.2023** dhe data e zhvillimit të procedurës së prokurimit elektronik është **24.06.2023 ora: 11:00** në faqen e internetit www.app.gov.al.

Njësia e Prokurimit